KIS Interpretimi 32
Aktivet jomateriale—Kostot e faqes së internetit

Referencat

- SNRF 3 *Kombinimet e biznesit*
- SNRF 15 *Të ardhurat nga kontratat me klientët*
- SNRF 16 *Qiratë*
- SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare*
- SNK 2 *Inventarët* (sipas rishikimit në 2003)
- SNK 16 *Aktivet afatgjata materiale (Toka, ndërtesa, makineri e pajisje)* (rishikuar në 2003)
- SNK 36 *Zhvlerësimi i aktiveve* (sipas rishikimit në 2004)
- SNK 38 *Aktivet jo-materiale* (rishikuar në 2004)

Çështja

1 Një njësi ekonomike mund të krijojë shpenzime të brendshme për zhvillimin dhe funksionimin e faqes së vet të internetit për mundësi përdorimi të brendshëm ose të jashtëm. Një faqe interneti e krijuar për përdorim të jashtëm mund të përdoret për qëllime të ndryshme si për shembull promovimi dhe reklamimi i produkteve dhe shërbimeve të njësisë ekonomike, pajisja me shërbime elektronike, dhe shitja e produkteve dhe shërbimeve. Një faqe interneti e krijuar për përdorim të brendshëm mund të përdoret për depozitimin e detajeve të klientit dhe politikave të kompanisë, si dhe për kërkimin e informacionit të nevojshëm.

2 Fazat e zhvillimit të një faqe interneti përshkruhen si më poshtë:

(a) Planifikimi - përfshin ndërmarrjen e studimeve të realizueshmërisë, përcaktimin e objektivave dhe specifikimeve, vlerësimin e alternativave dhe përzgjedhjen e preferencave.

(b) Zhvillimi i aplikacionit dhe infrastrukturës - përfshin marrjen e një emri fushe, blerjen dhe zhvillimin e pjesëve elektronike dhe funksionimin e programeve kompjuterike, instalimin e aplikimeve të zhvilluara dhe testimin e qëndrueshmërisë së programeve kompjuterike.

(c) Zhvillimi i Konceptimit Grafik - përfshin konceptimin e pamjes së faqes së internetit.

(d) Zhvillimi i Përmbajtjes - përfshin krijimin, blerjen, përgatitjen dhe transferimin në faqen e internetit të informacioneve të natyrës grafike dhe tekstuale përpara përfundimit të faqes së internetit. Ky informacion mund të ruhet ose në baza të dhënash të ndara të cilat mund të integrohen ose të mundësohen në faqen e internetit, ose mund të kodohet direkt në faqet e internetit.

3 Sapo përfundon faza e zhvillimit të faqes së internetit, fillon faza e Funksionimit. Gjatë kësaj faze, një njësi ekonomike mirëmban dhe pasuron aplikimet, infrastrukturën, konceptin grafik dhe përmbajtjen e faqes së vet të internetit.

4 Në momentin e kontabilizimit të shpenzimeve të brendshme të zhvillimit dhe funksionimit të faqes së internetit të njësisë ekonomike hasen këto probleme:

(a) nëse një faqe interneti është një aktiv jo-material i krijuar nga brenda njësisë ekonomike dhe është subjekt i kërkesave të SNK 38; dhe

(b) trajtimi i duhur kontabël i këtyre shpenzimeve.

5 Ky Interpretim nuk zbatohet për shpenzimet e kryera për blerjen, zhvillimin dhe funksionimin e pajisjeve elektronike (p.sh. serverë të internetit, serverë testues, serverë në veprim dhe lidhjet e internetit) të një faqeje interneti. Këto shpenzime kontabilizohen sipas SNK 16. Për më tepër, kur njësia ekonomike krijon shpenzime nga një furnizues i shërbimit të internetit për mirëmbajtjen e faqes së internetit të njësisë ekonomike, atëherë ky shpenzim duhet të njihet si i tillë (shpenzim) sipas paragrafit 46 të SNRF 18 dhe sipas *Kuadrit Konceptual për Raportimin Financiar* kur shërbimet janë marrë.

6 SNK 38 nuk zbatohet për aktivet jo-materiale të mbajtura për shitje nga njësia ekonomike në rrjedhën normale të biznesit (shih SNK 2 ose SNRF15) ose për dhënie me qira të aktiveve jomateriale të trajtuara në përputhje me SNRF 16. Për pasojë, ky Interpretim nuk zbatohet për shpenzimet e zhvillimit ose

funksionimit të faqes së internetit (ose programit të faqes së internetit) që mbahet për shitje te një njësi tjetër ekonomike ose që trajtohet në përputhje me SNRF 16.

Konsensusi

7 Një faqe interneti e njësisë ekonomike që vjen si rezultat i zhvillimit dhe është për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm është një aktiv jo-material i krijuar nga brenda njësisë ekonomike që është subjekt i kërkesave të SNK 38.

8 Faqja e internetit që rezulton nga zhvillimi duhet të njihet si aktiv jo material nëse dhe vetëm nëse përveçse ky aktiv kënaq kërkesat e përshkruara në SNK 38.21 për njohjen dhe matjen fillestare, edhe njësia ekonomike mund të plotësojë kërkesat e SNK 38.57. Në veçanti, një njësi ekonomike mund të jetë në gjendje të demonstrojë se faqja e internetit do të krijojë përfitime ekonomike në të ardhmen në përputhje me SNK 38.57(d) kur, për shembull, faqja e internetit mund të krijojë të ardhura nga porositë e kryera në të. Në rast se njësia ekonomike nuk është në gjendje të demonstrojë se faqja e internetit, e zhvilluar vetëm dhe kryesisht për promocion dhe reklamim të produkteve dhe shërbimeve të veta, do të gjenerojë përfitime ekonomike në të ardhmen, atëherë të gjitha shpenzimet për zhvillimin e kësaj faqeje interneti do të njihen si shpenzime kur ato janë kryer.

9 Çdo shpenzim i brendshëm në zhvillimin dhe funksionimin e faqes së internetit të njësisë ekonomike do të kontabilizohet në përputhje me SNK 38. Natyra e çdo aktiviteti për të cilin ndodhin shpenzimet (psh trajnimi i punonjësve dhe mirëmbajtja e faqes së internetit) dhe faza e zhvillimit dhe pas-zhvillimit të faqes së internetit duhet të vlerësohet për të përcaktuar trajtimin e duhur kontabël (udhëzime të mëtejshme janë dhënë në shtojcën e këtij Interpretimi). Për shembull:

(a) faza e Planifikimit është në natyrë e ngjashme me fazën e kërkimit në SNK 38.54–.56. Shpenzimet e kësaj faze do të njihen si shpenzime kur ato janë kryer.

(b) Faza e Zhvillimit të aplikacionit dhe Infrastrukturës, faza e Konceptimit Grafik dhe faza e Zhvillimit të Përmbajtjes, deri në nivelin e informacionit të ndryshëm nga reklamimi dhe promocioni i produkteve dhe shërbimeve të njësisë ekonomike, janë të ngjashme në natyrë me fazën e zhvillimit në SNK 38.57–.64. Shpenzimet e kryera në këto faza do të përfshihen në koston e faqes së internetit të njohur si aktiv jo-material sipas paragrafit 8 të këtij Interpretimi atëherë kur ky shpenzim kryhet direkt për këtë aktiv dhe është i nevojshëm për krijimin, prodhimin ose përgatitjen e faqes së internetit për ta bërë të aftë të operojë sipas kërkesave të drejtimit. Për shembull, shpenzimi për blerjen ose krijimin e informacionit (përveçse informacionit të reklamës dhe promocionit të produkteve dhe shërbimeve të njësisë ekonomike) të faqes së internetit, ose shpenzimi për të mundësuar përdorimin e informacionit të faqes së internetit (psh tarifa për t'u pajisur me një licencë për riprodhim) duhet të përfshihet në koston e zhvillimit vetëm atëherë kur plotësohet ky kusht. Megjithatë, në përputhje me SNK 38.71, shpenzimi për një aktiv jo-material që fillimisht është njohur si shpenzim në pasqyrat financiare të periudhës paraardhëse nuk do të njihet si kosto e aktivit jo-material në një kohë të mëvonshme (psh nëse kostot e të drejtës së autorit janë amortizuar totalisht, dhe faqja e internetit është pajisur tashmë me informacion).

(c) shpenzimet e fazës së Zhvillimit të përmbajtjes, deri në nivelin që informacioni është mundësuar për të reklamuar dhe promovuar produktet dhe shërbimet e njësisë ekonomike (psh fotografi numerike të produkteve) do të njihen si shpenzime kur ato janë kryer sipas SNK 38.69 (c). Për shembull, në rastin e kontabilizimit të shpenzimit të shërbimit profesional për marrjen në fotografi numerike të produkteve të njësisë ekonomike dhe për të mundësuar paraqitjen e tyre, ky duhet të njihet si shpenzim për aq kohë sa shërbimi profesional ka ndodhur gjatë procesit, dhe jo pasi fotografitë numerike janë paraqitur në faqen e internetit.

(d) Sapo përfundon faza e zhvillimit të faqes së internetit, fillon faza e Funksionimit. Shpenzimet e kësaj faze do të njihen si shpenzime kur ato janë kryer përveçse në rastin kur këto shpenzime plotësojnë kriterin e SNK 38.18.

10 Një faqe interneti që njihet si një aktiv jo-material sipas paragrafit 8 të këtij Interpretimi, duhet të matet pas njohjes fillestare duke zbatuar kërkesat e SNK 38.72–.87. Jeta e dobishme e një faqeje interneti duhet të vlerësohet sa më e shkurtër.

Data e Konsensusit

maj 2001

 © Fondacioni i SNRF-ve

Data e hyrjes në fuqi

Ky Interpretim hyn në fuqi më 25 mars 2002. Efektet e adoptimit të këtij Interpretimi do të merren parasysh në përdorimin e kërkesave të ndryshuara në versionin e SNK 38 që u publikua në 1998. Për këtë arsye, kur një faqe interneti nuk i plotëson kriteret e njohjes fillestare të një aktivi jo-material, por është njohur si i tillë më parë, ky zë duhet të mos njihet në datën që ky Interpretim hyn në fuqi. Kur një faqe interneti ekziston dhe shpenzimet për zhvillimin e saj plotësojnë kriteret e njohjes fillestare të një aktivi jo-material, por nuk janë njohur më parë si aktiv, atëherë aktivi jo-material nuk do të njihet në datën kur ky Interpretim hyn në fuqi. Kur një faqe interneti ekziston dhe shpenzimet për ta zhvilluar atë plotësojnë kriterin për njohjen fillestare si një aktiv jomaterial, dhe aktivi është njohur si e tillë më parë dhe është matur fillimisht në kosto, shuma fillimisht e njohur do të konsiderohet e duhur.

SNK 1 (i rishikuar në 2007) ndryshoi terminologjinë e përdorur në të gjithë SNRF-të. Në përputhje me këtë u ndryshua paragrafi 5. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore nga 1 janar 2009 e në vazhdim. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNK 1 (rishikuar në 2007) për një periudhë më të hershme, ndryshimet do të zbatohen për këtë periudhë më të hershme.[1]

SNRF 15 *Të ardhurat nga kontratat me klientët*, i publikuar në maj 2014, ndryshoi seksionin 'Referencat' dhe paragrafin 6. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë ndryshim kur zbaton SNRF 15.

SNRF 16, e publikuar në janar 2016, ndryshoi paragrafin 6. Njësia ekonomike e zbaton këtë ndryshim kur ajo zbaton SNRF 16.

Ndryshimet në referencat për kuadrin konceptual në standardet e SNRF-ve, të publikuara në vitin 2018, kanë ndryshuar paragrafin 5. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore raportuese që fillojnë më 1 janar 2020 e në vijim. Aplikimi më i hershëm lejohet nëse njëkohësisht një njësi ekonomike gjithashtu zbaton të gjitha ndryshimet e tjera të përfshira në *Ndryshimet në referencat për kuadrin konceptual në standardet e SNRF-ve.* Njësia ekonomike do të zbatojë ndryshimet në KIS-32 në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8 *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*.[2] Megjithatë, nëse një njësi ekonomike përcakton se aplikimi retrospektiv do të ishte i pazbatueshëm ose do të kërkonte kosto dhe përpjekje të panevojshme, ajo do të zbatojë ndryshimin e KIS-32 duke i'u referuar paragrafëve 23-28, 50-53 dhe 54F të SNK 8.

SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare* i publikuar në prill 2024 ndryshoi paragrafin 5. Njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 18.

---

1 Në prill 2024, BSNK publikoi SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare* dhe mbarti këto kërkesa të SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* tek SNRF 18.

2 Kur publikoi SNRF 18, BSNK ndryshoi titullin e SNK 8 në *Baza e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare*.